


Mbikëqyrja Parlamentare e Financave Publike dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit

Prof.Dr. Lindita Lati Milo



*“Identifikimi i instrumenteve dhe i eficencës së
proceseve mbikëqyrëse të Parlamentit nëpërmjet
përdorimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve
të aktivitetit auditues së
Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*



- Parlamentarizmit aktiv për rritjen e llogaridhënien dhe përgjegjshmërisë së qeverisë ndaj qytetarit
- KLSH dhe rritja e impaktit
- Instrumentat e bashkëpunimit ndërinstytucional
- Mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira


Parlamentarizmi aktiv- demokracia & mirëqeverisja



Parlamenti e ndërmer funksionin e mbikëqyrjes :
ex ante dhe *ex post*

MBIKËQYRJE EFEKTIVE- mekanizma vlerësimi

- ✓ rregullat që qeverisin mbikëqyrjen janë të mjaftueshme;
- ✓ parlamenti ka kapacitet të mjaftueshëm për mbikëqyrje të ekzekutivit;
- ✓ partitë opozitare dhe të pakicave, kanë mundësi të mjaftueshme për t'u angazhuar në mbikëqyrje
- ✓ mbështetja e publikut duke:
 - ❖ nxitur legjitimitetin parlamentar,
 - ❖ përmirësuar instrumentet e komunikimi,
 - ❖ përdorimi i mediave në aktivitetet mbikëqyrëse
 - ❖ transparenca dhe publikimi i të dhënave parlamentare,




KLSH- audituesi i jashtëm publik

Gjykata Evropiane e Auditit cilëson se:

- audituesit publik veprojnë në mënyrë pavarur në një kontekst shumë politik dhe janë parakusht për një demokraci funksionale.
- të shqyrtojnë financat dhe politikat e qeverive dhe të krijojnë besim tek publiku nëpërmjet forcimit të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë.
- Institucioni auditimit të jashtëm publik, ndihmon parlamentin të kontrollojë qeverinë, duke vepruar si ofrues shërbimesh dhe kujdestar i pavarur të interesave të qytetarëve.

Funksionimi i një organi të pavarur të auditimit publik të jashtëm është një parakusht për çdo vend që dëshiron të hyjë në Bashkimin Evropian.



Konstatohet se shumica e qeverive **nuk janë nën presion** të mjaftueshëm për të zbatuar rekomandimet e auditit, dhe vetëm në pak vende ekzekutivët raportojnë për publikun se çfarë kanë bërë për të adresuar këto rekomandime.

Rekomandohet një **ndërveprimi dinamik** midis legjislatrave dhe ISA-ve duke ndjekur publikisht veprimet e realizuara nga institucionet publike në përgjigje të rekomandimeve të auditimit, të cilat duhet të jenë në mënyrën dhe kohën e duhur.



Eficienca dhe bashkëpunimi: Parlament-KLSH


- dërgimin e raporteve në parlament dhe publikimin e tyre në të njëjtën kohë;
- duke u siguruar që raportet të shpërndahen midis të gjithë anëtarëve/komisioneve përkatëse;
- ofrimin e prezantimeve dhe përmbledhje ekzekutive mbi raportet;
- duke përdorur njoftimet për shtyp për të nxjerrë në pah çështje të rëndësishme të përfshira në raporte;
- duke qenë përzgjedhës në raportet e paraqitura në parlament ose duke dhënë këshilla se cilat raporte duhet të zgjedhin për shqyrtim;
- duke konsideruar raportet tematike që mbledhin rezultatet nga auditimet e mëparshme, pra mbi zbatimin e rekomandimeve.




Kontrolli i Lartë i Shtetit

- SIGMA mbi transparencën e raportimit dhe të shqyrtimit të buxhetit, 2020 vs 2017:
 - +2** pikë në cilësinë e raportimit financiar vjetor për përdorimin e financave publike nga KLSH,
 - 2** pikë në lidhje me afatin e diskutimit parlamentar të raporteve të tij.
 - 4** pikë referuar shkallës së përdorimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH-së nga legjislatura, *“Parlamenti ka procedura formale për trajtimin e dy raporteve të detyrueshme të KLSH-së”*.
- RP i KE-së (2023), për rritjen e mbikëqyrjes dhe presionit të parlamentit ndaj institucioneve publike të audituara për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, nëpërmjet seancave më të shpeshta parlamentare dhe funksionimit të monitorimit parlamentar për të vlerësuar rregullisht ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga qeveria.

Bashkëpunim: Kuvendit - KLSH



Instrumentat e bashkëpunimit ndërinstitucional



PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE

Institucione Rezoluta **Vendime** Perdorues

Numer Protokollit	Titull	Nga	Per	Data e krijimit
197	Zbatimi i Rekomandimeve	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	12-11-2019
197	Zbatimi i rekomandimeve	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Bashkia Korçë	27-05-2020
Nr.197	Vendim mbi zbatimin e rekomandimeve	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Bashkia Vlorë	27-05-2020
Vendim Nr. 67, datë 28.04.2023	Vendim Nr. 67, datë 28.04.2023 - diskriminim për shkak të "gjinisë", "shtatzënisë" dhe "çdo shkak tjetër".	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Bashkia Tiranë	27-05-2020
Vendim Nr. 66, datë 27.04.2023	Vendim Nr. 66, datë 27.04.2023 - diskriminim për shkak të "aftësisë së kufizuar"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Bashkia Kamëz	17-11-2020
Vendim Nr.56, datë 12.04.2023	Vendim Nr.56, datë 12.04.2023 - diskriminimit për "çdo shkak tjetër"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	12-11-2019



- Institucione
- Rezoluta
- Vendime**
- Perdorues

Rekomandimi	Instucion Marrës	Afati	LLoj rekomandimi	Shpjegimi i Institucionit tuaj	Kontributi i Këshillit të Ministrave	Komenti i Kuvendit të Shqipërisë	Përgjigjia e institucionit	Statusi
Për punonjësit që marrëdhëniet ... me shume	Bashkia Korçë	Ne vijimësi	Masa Disiplinore				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
Bashkia Korçë të marrë masa të ... me shume	Bashkia Korçë	Menjëherë	Masa Organizative				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
Nga Bashkia Korçë, të kërkohet ... me shume	Bashkia Korçë	Brenda 6 (gjashtë) mujorit	Shperblim demi				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
Nga Bashkia Korçë, të kërkohet ... me shume	Bashkia Korçë	Brenda 6 (gjashtë) mujorit	Shperblim demi				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlo ... me shume	Bashkia Korçë	Menjëherë	Shperblim demi				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
3.1. Rekomandim: Bashkia Korçë ... me shume	Bashkia Korçë	Menjëherë	Masa Organizative				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO



PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE

- Institucione
- Rezoluta
- Vendime**
- Perdorues

Rekomandimi	Instucion Marrës	Afati	LLOj rekomandimi	Shpjegimi i Institucionit tuaj	Kontributi i Këshillit të Ministrave	Komenti i Kuvendit të Shqipërise	Përgjigjia e institucionit	Statusi
6.3 Nga Bashkia Korçë, Bashkia ... me shume	Bashkia Vlorë	Brenda 6 (gjashtë) mujorit	Shperblim demi				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
D.2.2 Në mbështetje të shkronj ... me shume	Bashkia Vlorë	Brenda 6 (gjashtë) mujorit	Masa Disiplinore				Pranuar :PO	Pa zbatuar Perfunduar :PO
4.2 Bashkia Vlorë të marrë mas ... me shume	Bashkia Vlorë	Menjëherë	Masa Organizative				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
6.2 Nga Bashkia Vlorë, të kërk ... me shume	Bashkia Vlorë	Brenda 6 (gjashtë) mujorit	Shperblim demi				Pranuar :PO	Pa zbatuar Perfunduar :JO
4.1 Bashkia Vlorë dhe Drejtori ... me shume	Bashkia Vlorë	Menjëherë	Masa Organizative				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO
3.1 Bashkia Vlorë, Drejtorja e ... me shume	Bashkia Vlorë	Menjëherë	Masa Organizative				Pranuar :PO	Zbatuar Perfunduar :PO

Mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

Konstatimet

Absorbim JO i plotë të informacionit të paraqitur në raportet e KLSH-së, për shkak të:

- volumit të tyre,
- specifikave në njohuritë teknike
- kohës së kufizuar të anëtarëve të parlamentit për t'u përgatitur për seancat e diskutimeve.

Rekomandimet

Ngritja dhe funksionimi i një komision të veçantë apo nënkomisioni, si pjesë e KEF-së, të përhershëm të specializuar për buxhetin dhe auditimin publik, si një nga mjetet për të rritur më tej mbikëqyrjen e aktivitetit financiar të qeverisë.

.....mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

Konstatimet

Bashkëpunim formal dhe minimalist midis Kuvendit dhe KLSH-së.

Rekomandimet

Platformave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis KLSH-së dhe Parlamentit nëpërmjet:

- (i) komisioneve parlamentare sektoriale, të cilat duhet të trajtojnë në mënyrë specifike raportet e auditimit të performancës sipas fushave të përkatësisë;
- (ii) përcaktimi i një agjende të veçantë dhe në afatet e duhura për paraqitjen e raporteve të KLSH-së;
- (iii) përcaktimi i personave respektivë të kontaktit si dhe autoritetin e tyre.

Sfidat e Mbikëqyrjes Parlamentare mbi Financat Publike në Shqipëri

- 1. Kapacitetet e Kufizuara Institucionale**
- 2. Dominimi i Ekzekutivit ndaj Legjislativit**
- 3. Politizimi i Procesit**
- 4. Përdorimi i Kufizuar i Raporteve të Auditimit të KLSH-së**
- 5. Transparenca dhe Përfshirja e Kufizuar e Publikut**
- 6. Zbatimi i Parregullt i Rregullave Buxhetore**
- 7. Mungesa e Mekanizmave Efektive të Ndjekjes**

.....mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

Rekomandohet MOU mbi procedurat e bashkëpunimit dhe finalizimi i tij, duke synuar: realizimin e takimeve në nivelet teknike;

- përfshirjen e komisioneve të tjera parlamentare;
- sigurimi që të gjitha raportet e KLSH-së zotërohen nga të gjithë anëtarët respektivë të parlamentit;
- organizimi i trajnimeve/ informime mbi e aktivitetin e KLSH-së për anëtarët e rinj të parlamentit dhe /ose këshilltarët e komisioneve;
- organizimi i konferencave të përbashkëta, tryeza të rrumbullakëta apo workshope;
- informimi i përgjithshëm nëpërmjet përmbledhjeve ekzekutive të raporteve të auditimit.

Pavarësisht, se KLSH është agjent i parlamentit në realizimin e misionit të mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të përdorimit të fondeve publike, ky instrument mund të ndikoj në rritjen e angazhimit për të përdorur të gjithë informacionin që mundësojnë raportet e auditimit si dhe për të kërkuar zbatimin e rekomandimeve nga institucionet publike.

.....mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nëpërmjet:

- raportimit në mënyrë të veçantë mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nga entitet publike;
- organizimin nga komisionet parlamentare përkatëse seanca dëgjimore me entet publike të audituara;
- komisionet parlamentare të kërkojnë në mënyrë specifike planin e veprimit nga qeveria apo institucione të veçanta për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;

Në rastet serioze të mos zbatimit të rekomandimeve, Parlamenti të shohë mundësinë e veprimeve administrative (politike, financiare apo disiplinore).

.....mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

KEF duhet të sigurojë se i ka të gjitha kapacitetet për të shqyrtuar raportet e auditimit në kohën e duhur dhe në mënyrë sistematike.

Parlamenti dhe KLSH-ja duhet të mbajnë një dialog rreth:

- përmbajtjes dhe formatit të raporteve të auditit, për t'u siguruar se ato përfshijnë informacionin që parlamentit ka nevojë
- përcjelljen e qartë dhe të kuptueshëm të gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për institucionet publike.


.....mësimet nga eksperiencia-praktikat më të mira.....

Parlamenti duhet të deklarojë publikisht se do të monitorojë dhe raportojë mbi aktivitet e tij mbikëqyrëse. Kjo qasje ndihmon për ta bërë vetë parlamentin përgjegjës para publikut për performancën e tij.

Mbikëqyrja efektive parlamentare garantohet nga bashkëpunimi dhe përpjekjet e deputetëve, shoqërisë civile dhe institucioneve mbikëqyrëse, me mbështetjen e publikut të gjerë.

Rekomandime.....

- **Ndërtimi i Kapaciteteve:** Trajnimi i deputetëve dhe stafit mbështetës mbi menaxhimin e financave publike.
- **Forcimi i Pavarësisë së KLSH:** Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe mbështetjes ligjore për Institucionin e Auditimit të Jashtëm Publik.
- **Angazhimi I publikut & Rritja e Transparencës:** Përfshirja më e madhe e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset buxhetore dhe mbikëqyrëse.
- **Përdorimi i Teknologjisë:** Zhvillimi i platformave digjitale për të ndarë informacion financiar në kohë reale.
- **Përforcimi i Ndjekjes:** Krijimi i mekanizmave të detyrueshëm për zbatimin e rekomandimeve parlamentare dhe të KLSH-së.



JU FALEMINDERIT!